



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Pranuar - Prilajeno No/Četno			
08.05.2014			
Nr./ organit Org.broj	Numri/Broj	Shprehje Prilaj	Vlera Vrednosit
01-013/618			

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Ne bazë të nenit 51.2 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta zyrtare nr 28/2008, dhe nenit 47 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 013/492 të datës 21.04.2011 Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 29.04.2014 aprovon këtë:

## V E N D I M PËR EMËRIMIN E KOMITETIT PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

### Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë EMËRON Komitetin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka këtë përbërje:

1. Xhylsime Qamili – anëtare e komitetit,
2. Taip Alidema – anëtar i komitetit,
3. Mirlinda Sadiku – anëtare e komitetit,
4. Vjollca Sylejmani – anëtare e komitetit,
5. Abide Osmani – nga shoqëria civile- anëtare e komitetit,

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në takimin e parë do ta zgjedh kryesuesin e këtij komiteti.

### Neni 2

Komiteti nga neni 1 i këtij vendimi ka për detyrë që të shqyrtoj çështjet të cilat kanë të bëjnë me gjendjen në Shëndetësi dhe gjendjen Sociale të banorëve të Komunës së Vitisë dhe të jep vërejtje, propozime dhe sugjerime për tejkalimin e gjendjes në shëndetësi dhe në mbrojtjen sociale.

Kryesuesi i Kuvendit, Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Kryesuesi i komitetit më detalisht mund ti përcaktojnë detyrat e këtij komiteti.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Kuvendit dhe Kryesuesi i Komitetit.

### Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Anëtarëve të komitetit
2. Shërbimit të Kuvendit
3. Arkivit

KRYESUESI I KUVENDIT

Naim Pira

